



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

DATA	14.06.2022
PËR/ZA/TO:	Z.Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Glllogocit
CC:	Znj.Venera Çerkini,zv.Sekretare e Përgjithshme/MAPL Z.Besim Myrtezani,zv.Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave/MAPL Znj.Leonita Shabani,zv.Sekretare e Përgjithshme/ME Z.Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave/MAPL Z.Kujtim Aliu,Zyrtar i lartë Ligjor/MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z.Adem Ahmetaj, zv.Udhëheqës i NJPMNP-së
NGA/OD/FROM:	Arbërore Bernica-Hasani,analiste/NJPMNP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Glllogocit

I nderuar,

Në pajtim me Rregullore (qrk) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (qrk) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Ekonomisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullore (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve publike/NJPMNP/Ministria e Ekonomisë/ME, ka pranuar për shqyrtim aktin komunal në vijim:

Vendimin nr.prot.02-020/04-24071 i Kuvendit të Komunës të Glllogocit i miratuar me datë 30.05.2022, i pranuar në ME me nr.prot.1321 dt. 03.06.2022, për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi Sh.a.", i miratuar nga Kuvendi dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Mbështetur në ligjin nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike neni 5 paragrafi 2 rregullon "Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar "

Ministria e Ekonomisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës është në harmoni me dispozitën 5.2 të ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike dhe mund të prodhoj efekte juridike.

Ministria e Ekonomisë, mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!



Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-029/04-24081 dt. 30.05. 2022

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, Në bazë të nenit 5, pika 5.2, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike me nr.03/L-087 dhe nenit 34, pika 34.6 e Statutit të Komunës së Glllogocit, i dt. 16.09.2008, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit në mbledhjen rregullt të mbajtur me datë **30. 05. 2022**, miraton këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike

“PASTRIMI “

Neni 1

Me këtë Vendim formohet **Komisioni Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike**

“PASTRIMI “ i komunës së Drenasit

Neni 2

Në kuadër të këtij Komisioni Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen publike, në bazë të nenit 5, pika 5.2, në përbërje duhet të jenë: Një anëtar i emëruar nga Kryetari i komunës dhe Dy anëtarë të emëruar nga Kuvendi i komunës.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Komunal të Aksionareve në bazë të nenit 7, pikat (7.1-7.3) janë si me poshtë:

Komisioni Komunal i Aksionareve ka të drejtë të veprojë në emër të komunës në përpunje me ligjin për shoqëritë tregtare, se si do të ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.

Aksionari(ët) e një NP do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë,

Nëse performanca e NP-së devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve për vitin përkatës financiar, Aksionari(ët) do të kërkojnë nga Bordi i Drejtorëve që të përgatisë dhe t’u dorëzojë atyre një raport i cili i shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe Aksionari(ët) do të marrin të gjitha masat e duhura korrigjuese.

Nëse një NP dështon në arritjen e qaveve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, personi(at) përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit është i detyruar që të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të Drejtorëve ose shumicës së anëtarëve të tij. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës nga Bordi ose anëtarët përkatës të bordit, përveç nëse Aksionari(ët) konstatojnë se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të

rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të Aksionarit do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij Neni 7.3, dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi: (i) Kuvendit, për NP-të Qendrore, ose (ii) Kuvendit përkatës Komunal, për NP-të Lokale.

Neni 4

Grupi punues është në këtë përbërje:

1. Lumnije Krapit, e caktuar nga Kryetari I komunës
2. Malsore Cakiqi Kuvendi i Komunës,
3. Mergim Pirraku Kuvendi i Komunës,

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e kryetarit të Komunës dhe Drejtoria përkatëse.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari